

Numri i lëndës: KSC-BC-2018-01

Prokurori kundër Driton Lajçit

Vendos: Gjykatësi i Vetëm

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Mbrojtësi i Specializuar i Driton Lajçit

Data: 25 korrik 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i Korigjuar i Kërkesës së Dytë për Urdhër për Prokurorin e Specializuar
që të Pushojë Hetimin kundër Driton Lajçit**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësi i Specializuar

Tobi Kadman

I. HYRJE

1. Më 15 qershor, Mbrojtësi i Specializuar i z. Driton Lajçi ("Mbrojtja e Lajçit") kërkoi, për herë të parë, një urdhër për Prokurorin e Specializuar që të pushojë hetimin kundër z. Lajçi, duke pasur parasysh se deri në atë moment hetimi kishte zgjatuar për më shumë se dy vjet.¹
2. Më 23 korrik 2021, Gjykatësi i Vetëm lëshoi një vendim ku hodhi poshtë Kërkesën,² duke konstatuar se hetimi nga 3 maji 2019 deri në datën e atij vendimi nuk binte në kundërshtim me kriterin e "periudhës së arsyeshme" sipas rregullës 47(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja").³
3. Më 29 korrik 2021, Mbrojtja e Lajçit dorëzoi kërkesë për leje për apelim përmes autorizimit.⁴
4. Më 24 gusht 2021, Gjykatësi i Vetëm miratoi lejen për apelimin e një pike, që thotë:

¹ KSC-BC-2018-01, F00172, Kërkesë për Urdhër për Prokurorin e Specializuar që të Pushojë Hetimin kundër z. Driton Lajçi, 15 qershor 2021, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F00172/RED.

² KSC-BC-2018-01/F00180/RED, Vendim mbi Kërkesën për Urdhër për Prokurorin e Specializuar që të Pushojë Hetimin kundër Driton Lajçit, 23 korrik 2021, publik.

³ Po aty, para. 32, 35(a).

⁴ KSC-BC-2018-01/F00181, Mbrojtësi i Specializuar, Kërkesë për Autorizim për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër për Prokurorin e Specializuar që të Pushojë Hetimin kundër Driton Lajçit, 29 korrik 2021 (njoftuar më 30 korrik 2021), konfidenciale.

Nëse Gjykatësi i Vetëm ka gabuar në konstatimin se afati i përcaktuar në nenin 159 të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2012 të Republikës së Kosovës ("KPPK") është tërësisht "*i pazbatueshëm*" dhe *de facto* duhet të shpërfilllet krejtësisht në interpretimin e kuadrit të "*periudhës së arsyeshme*" sipas rregullës 47 të Rregullores, sikurse është përdorur nga gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës[.]⁵

5. Më 3 shtator 2021, Mbrojtja e Lajçit dorëzoi apelin e saj.⁶
 6. Më 1 tetor 2021, Paneli i Apelit lëshoi vendimin e vet.⁷ Paneli ra dakord me Gjykatësin e Vetëm se neni 159(1) i KPPK-së nuk zbatohet për kërkimin e pushimit të një hetimi në përputhje me rregullën 47(1) të Rregullores.⁸
- Gjithsesi, në paragrafin [21] dhe [22] thotë gjithashtu se:

⁵ F00184, Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelin e Vendimit F00180, 24 gusht 2021 ("Vendimi për Leje për Apel"), para. 5(a), 21, 32(b). Shih gjithashtu F00181, Kërkesë për Autorizim për Leje për Apelin të Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër për Prokurorin e Specializuar që të Pushojë Hetimin kundër Driton Lajçit, 29 korrik 2021 (konfidencial, u riklasifikua si publik më 24 gusht 2021) ("Vendimi për Leje për Apel"); F00182, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës për Autorizim për Leje për Apelin të Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër për Prokurorin e Specializuar që të Pushojë Hetimin kundër Driton Lajçit, 11 gusht 2021 (konfidenciale, u riklasifikua si publike më 24 gusht 2021); F00183, Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë lidhur me Kërkesën e Mbrojtjes për Autorizim për Leje për Apelin të Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër për Prokurorin e Specializuar që të Pushojë Hetimin kundër Driton Lajçit, 16 gusht 2021 (konfidenciale, u riklasifikua si publike më 24 gusht 2021).

⁶ F00002, Apel Kundër Vendimit KSC-BC-2018-01/F00180 lidhur me Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit, 3 shtator 2021.

⁷ KSC-BC-2018-01/IA001/F00005, Vendim mbi Apelin Kundër Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër për Prokurorin e Specializuar që të Pushojë Hetimin kundër Driton Lajçit, publik.

⁸ Po aty, para. 16-17.

“21. Përkundrazi, Gjykatësi i Vetëm pranoi se në përcaktimin e Rregullores së saj, Dhomat e Specializuara do të bazohen në KPPK-në. Gjykatësi i Vetëm vendosi ta interpretojë fjalën “do të bazohen” në kuptimin që ndonëse gjykatësit duhet të kenë parasysh KPPK-në kur të miratojnë Rregulloren, “ata nuk duhet të jenë të detyruar të zbatojnë ndonjë dispozitë të veçantë të përfshirë në atë Kod”. Paneli është bindur se ky interpretim është i saktë dhe nuk bie ndesh me rregullën 4(1) të Rregullores e cila kërkon që Rregullorja të interpretohet në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar në nenin 3 të Ligjit dhe, nëse është e përshtatshme, me KPPK-në.

“22. Paneli konstaton se, ndonëse *neni 159(1) i KPPK-së është udhëzues dhe mund ta drejtojë panelin përkatës në përcaktimin se çfarë përbën “periudhë të arsyeshme” për një hetim sipas rregullës 47(1) të Rregullores*, ai nuk ka efekt detyrues pasi nuk është i përfshirë shprehimisht në Ligj. Për interpretimin e Ligjit dhe të Rregullores në dispozicion të Dhomave të Specializuara janë dhe burime të tjera, sikurse është e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”). Në këtë aspekt, Paneli vëren se Gjykatësi i Vetëm vlerësoi kriterin e “periudhës së arsyeshme” sipas rregullës 47(1) të Rregullores duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, të cilat, të zbatuara në këtë çështje, janë:

(i) kompleksiteti i hetimit; (ii) sjellja e Lajçit dhe e autoriteteve përkatëse administrative dhe gjyqësore; dhe (iii) çfarë rrezikon Lajçi. Paneli rikujton se sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, KEDNJ-ja ka epërsi ndaj ligjeve vendore. Paneli nuk sheh ndonjë gabim në faktin se Gjykatësi i Vetëm u mbështet në standardet e GJEDNJ-së dhe jo në dispozitat e KPPK-së dhe hedh poshtë argumentin e Lajçit për këtë.” **(Theksimi i shtuar)**

4. Më 2 qershor 2022, Mbrojtja e Laçit i dorëzoi Prokurorit të Specializuar kërkesën e dytë për pushimin e menjëhershëm të hetimit.⁹
7. Kërkesa u refuzua nga Prokurori i Specializuar në letrën e datës 9 qershor 2022,¹⁰ me argumentin, pa dhënë shpjegime të mëtejshme, se:

“Konstatimet e Gjykatësit të Vetëm, të bazuara në standardet e miratuara nga Gjykata e Apelit, janë të sakta. Hetimi aktual vazhdon të jetë mjaft kompleks. ZPS-ja ka kryer hetime shtesë të cilat janë zgjatur për shkak të dhënies së informacionit të paplotë. ZPS-ja parashikon hapa të mëtejshëm hetimorë. Aktualisht z. Lajçi nuk është i paraburgosur. Duke marrë parasysh të gjithë këta faktorë, kohëzgjatja e hetimeve vazhdon të jetë e arsyeshme.”

⁹ Shih Shtojcën A konfidenciale.

¹⁰ Shih Shtojcën B konfidenciale.

8. Paragrafi i mësipërm përbën tërësinë e informacionit të marrë në lidhje me hetimet e ZPS-së të kryera që nga vendimi i Panelit të Apelit më 1 tetor 2021.
- Në fakt, ZPS-ja nuk ka pasur më kontakt me z. Lajçi apo me përfaqësuesit e tij ligjor që nga intervista e tij si i dyshuar më 17 tetor 2019.

II. LIGJI

6. Sipas vendimit të Panelit të Apelit,¹¹ standardet e zbatueshme për rishikimin e periudhës së arsyeshme për hetimin e një të dyshuari, sipas rregullës 47(1), janë standardet e përcaktuara në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("KEDNJ") dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ"),¹² që në vijim përfshin faktorët për t'u marrë parasysh në përcaktimin e periudhës së arsyeshme të hetimit, që do të thotë se çdo çështje varet nga faktet e veta:

- (i) kompleksiteti i hetimit;
- (ii) sjellja e z. Lajçi;

¹¹ KSC-BC-2018-01/IA001/F00005 Vendim mbi Apelin kundër Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër për Prokurorin e Specializuar që të Pushojë Hetimin kundër Driton Lajçit, publik. Para 22.

¹² Gjykatësi i Vetëm në Vendimin e 23 korrikut 2021 citoi tri aktgjykime të GJEDNJ-së, konkretisht, *Boddaert v. Belgium*, no. 12919/87, Judgment, 12 October 1992, para. 36; *Pélissier and Sassi v. France* [GC], no. 25444/94, Judgment, 25 March 1999, para. 67; and ECtHR, *Khlebiuk v. Ukraine*, no. 2945/16, Judgment of 25 July 2017, para. 78.

(iii) sjellja e autoriteteve përkatëse administrative dhe gjyqësore;
dhe

(iv) çfarë rrezikon z. Lajçi.

7. Megjithatë, është parashtruar se ndonëse Paneli i Apelit konstatoi se neni 159(1) i KPPK-së nuk zbatohet drejtpërdrejt në rregullën 47(1) të Rregullores, Paneli konfirmoi se i pari “...është udhëzues dhe mund ta drejtojë panelin përkatës në përcaktimin se çfarë përbën “periudhë të arsyeshme” për një hetim sipas rregullës 47(1) të Rregullores.”¹³ Rrjedhimisht, ndonëse është konstatuar se neni 159(1) i KPPK-së nuk zbatohet drejtpërdrejt, Gjykatësi i Vetëm ende mund të mbështetet dhe ta marrë parasysh në përcaktimin e kriterit të periudhës së arsyeshme.

8. Neni 159(1) KPPK-së përcakton se:

“Kur fillon hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi pushohet menjëherë.”

9. Rregulla 47(1) e Rregullores përcakton se:

¹³ KSC-BC-2018-01/IA001/F00005, Vendim mbi Apelin kundër Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër për Prokurorin e Specializuar që të Pushojë Hetimin kundër Driton Lajçit, publik. Para 22.

“Në qoftë se Prokurori i Specializuar nuk paraqet aktakuzë para Dhomave të Specializuara sipas nenit 38(4) të Ligjit brenda një *periudhe të arsyeshme* pasi personi të jetë bërë i dyshuar dhe të jetë informuar për këtë, i dyshuari mund t’i kërkojë Prokurorit të Specializuar pushimin e hetimit kundër tij ose saj.” (Theksimi i shtuar)

III. PARASHTRIMET

A. Pikënisja për vlerësimin e “periudhës së arsyeshme”

10. Parashtrohet se z. Lajçi u njoftua zyrtarisht se ishte i dyshuar më 3 mars 2019 ose rreth kësaj date, kur u takua me z. Kuai Hong Ip, në atë kohë Zëvendësprokuror i Specializuar, dhe iu dha urdhri për sekuestrimin e telefonit të tij dhe më pas fletëthirrja për t’u intervistuar si i dyshuar.¹⁴
11. Është parashtruar se kohëzgjatja e hetimit kundër z. Lajçi që kur u njoftua për t’u intervistuar si i dyshuar e deri më sot nuk mund të konsiderohet më si e arsyeshme, pasi kanë kaluar tre vjet dhe dy muaj që kur ai u njoftua zyrtarisht se po hetohej dhe nuk është ngritur/njoftuar publikisht aktakuzë.

¹⁴ KSC-BC-2018-01/F00180/RED, Vendim mbi Kërkesën për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit, 23 korrik 2021, publik. Para 21. Shih gjithashtu Shtojcën A.

12. Në përcaktimin e arsyeshmërisë, në çdo rast që thuhet se është shkelur periudha e arsyeshme, hapi i parë është që të merret parasysh periudha që ka kaluar. Sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së, periudha fillon me *“njoftimin zyrtar që i jepet një individ nga autoriteti kompetent me pretendimin se ai ka kryer veprë penale”*.¹⁵ Pasi një individ informohet se është zyrtarisht i dyshuar për një veprë penale, nga ai moment është i interesuar që të përcaktohet sa më shpejt me vendim gjyqësor fajësia ose pafajësia e tij. Sikurse u përcaktua më lart, në këtë çështje kjo gjë ndodhi më 3 maj 2019. Periudha kohore mbaron kur përfundon procesi ose kur vendimi është i formës së prerë.¹⁶ Në rastin konkret, vazhdojnë hetimet dhe rrjedhimisht, data përkatëse do të jetë dalja e vendimit të Gjykatës të Vetëm mbi këtë kërkesë.
13. Pasi të jetë përcaktuar periudha kohore, arsyeshmëria duhet të vlerësohet nga kompleksiteti i çështjes, sjellja e të akuzuarit, sjellja e autoriteteve përkatëse dhe çfarë rrezikon z. Lajçi.
14. Secili nga këta faktorë diskutohet me radhë në vijim.

B. Kompleksiteti i hetimit

15. Sa i përket kompleksitetit të çështjes, Mbrojtja e Lajçit parashtroi se ka mospërputhje thelbësore në lidhje me kompleksitetin për sa i takon pengimit

¹⁵ ECtHR, *Eckle v. Federal Republic of Germany*, judgment of 21 June 1983, Series A no. 65, para. 73.

¹⁶ ECtHR, *Scopatelli v. Italy*, judgment of 23 November 1993, Series A no. 278, para. 18.

të drejtësisë, edhe kur ka lidhje me ndërhyrjet e bëra nga qeveria dhe përfshin shumë të pandehur të mundshëm nga njëra anë dhe, për shembull, krimeve komplekse ndërkombëtare nga ana tjetër. Sikurse pretendohet nga Prokurori i Specializuar, këta faktorë mund ta bëjnë çështjen më komplekse.

16. Lidhur me jurisprudencën e GJEDNJ-së ku mbështetet ZPS-ja,¹⁷ Mbrojtja e Lajçit rithekson argumentin e mëparshëm se ZPS-ja lë jashtë faktin se procesi penal në fjalë kishte të bënte me krime financiare që përfshihen brenda pesë juridiksioneve të tjera dhe kërkoheshin prova nga këto pesë juridiksione, kurse hetimi kundër z. Lajçi ka të bëjë me një juridiksion dhe një pretendim për pengim të drejtësisë.
17. Gjithashtu, Mbrojtja e Lajçit përsëriti se nuk ka prova për pretendimin e ZPS-së se ish-anëtarë të qeverisë së Kosovës, ose ndonjë person tjetër, u përfshinë në pengimin e pretenduar për të cilin akuzohet z. Lajçi, gjë që do ta shtonte më tej kompleksitetin e hetimit.

C. Sjellja e z. Lajçi

18. Mbrojtja e Lajçit përsërit argumentet e saj të mëparshme se ZPS-ja nuk duket se argumenton që z. Lajçi nuk dorëzoi asnjë dokument të kërkuar, ose madje

¹⁷ KSC-BC-2018-01, F00175, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit*, 25 qershor 2021, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00175/RED, ku Prokurori i Specializuar në paragrafin [21] iu referua çështjes gjyqësore në GJEDNJ *Arewa v. Lithuania*, no. 16031/18, Judgment, 9 March 2021, para. 54.

një pjesë të konsiderueshme të tyre, por se ai nuk bashkëpunoi në hetimin e ZPS-së kundër tij. Është për t'u theksuar se z. Lajçi dha dorëheqje nga posti i tij qeveritar më 2 nëntor 2020. Rrjedhimisht, sugjerimi se ai është përfshirë në veprimtari që pengojnë procesin që po zhvillohet, ose ka marrë pjesë apo është përgjegjës në pengimin e hetimit nga Qeveria, është i sajuar dhe i pabazë.

19. Mbetet e paqartë se cilat kërkesa zyrtare i janë bërë z. Lajçi personalisht për dorëzimin e informacionit që pretendohet se mungon dhe është në zotërimin e tij nuk është paraqitur asnjë provë që të tregojë se ai nuk ka bashkëpunuar. Gjithsesi, në lidhje me faktin se sa ka kontribuar z. Lajçi në vonimin e hetimit duke mos bashkëpunuar, sikurse u përcaktua në *Ledone (Nr1) kundër Italisë/Ledonne (No. 1) v. Italy*,¹⁸ nuk ka kriter të përcaktuar në nenin 6 të KEDNJ-së që një person i akuzuar të bashkëpunojë aktivisht me autoritetet në hetimin kundër tij.

20. Më parë Gjykatësi i Vetëm ka konstatuar se veprimet e z. Lajçi kontribuan pjesërisht në vonimin e hetimit pasi ai drejtonte një departament në Ministrinë e Drejtësisë në atë periudhë.¹⁹ Megjithatë, parashtrohet se nga informacioni në dispozicion nuk është e qartë dhe nuk mund të përcaktohet qartësisht se çfarë veprimesh pretendohet se ka kryer z. Lajçi dhe në çfarë mase kanë kontribuar

¹⁸ ECtHR, *Ledonne (No. 2) v. Italy*, Second Section, Appl. No. 38414/97, judgment of 12 August 1999, para. 19.

¹⁹ KSC-BC-2018-01/F00180, Vendim mbi Kërkesën për Urdhër për Prokurorin e Specializuar që të Pushojë Hetimin kundër Driton Lajçit, 23 korrik 2021, konfidencial, para 30. Versioni i redaktuar KSC-BC-2018-01/F00180/RED.

ato në vonimin e hetimit. Thjesht pretendimi se veprimet e tij kontribuan pjesërisht në vonimin e hetimit pa dhënë informacion tjetër se sa kanë ndikuar ato në këtë vonesë, nuk mjafton për të justifikuar periudhën e arsyeshme në lidhje me këtë faktor. Gjithashtu, duke pasur parasysh se z. Lajçi dha dorëheqje nga posti i tij qeveritar më 2 nëntor 2020, edhe nëse ZPS-ja ka mundur të vërtetojë se ai ka kontribuar në vonimin e hetimit, që është hedhur poshtë, për periudhën nga 3 maji 2019 deri më 2 nëntor 2020, ata nuk kanë llogaritur periudhën pas largimit të tij nga posti qeveritar, përkatësisht nëntëmbëdhjetë muajt e fundit.

D. Sjellja e autoriteteve përkatëse administrative dhe gjyqësore

21. Kriter tjetër është sjellja e autoriteteve përkatëse. Në këtë aspekt, ka një mungesë të plotë informacioni mbi të cilin Mbrojtja e Laçit mund të komentojë. Megjithatë, çdo vonesë e shkaktuar nga mungesa e pretenduar e bashkëpunimit ose mosdhënia e informacionit nga Qeveria e Kosovës në përgjithësi, nuk i atribuohet z. Lajçi, dhe nuk mund të jetë faktor kaq i rëndësishëm për të përcaktuar se hetimi kundër z. Lajçi, për më shumë se tre vjet, është i arsyeshëm.
22. Gjithashtu, sa i përket sugjerimit se Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për vonimin e hetimit, ZPS-së duhet t'i rikujtohet se është organ vendor i Republikës së Kosovës për ndjekje penale dhe jo subjekt i veçantë i pavarur

që vepron në zbrazëti dhe është përgjegjëse për çdo dështim të perceptuar nga ana e shtetit për të avancuar hetimet e veta.

23. Është detyrë e autoriteteve përkatëse vendore të organizojnë sistemin e tyre gjyqësor në mënyrë të tillë që institucionet shtetërore të përmbushin kriteret e neni 6(1) të KEDNJ-së.²⁰ Organizimi administrativ i sistemit të tij gjyqësor, përfshirë vonesat e shkaktuara nga mungesa e personelit gjyqësor apo administrativ, punët grumbulluara ose angazhime të tjera, janë përgjegjësi e autoriteteve përkatëse.²¹ Problemet sistematike dhe të institucionalizuara brenda një sistemi gjyqësor që shkaktojnë vonesa të përsëritura dhe janë shkak për shqetësim konkret, duhet të trajtohen nga organet përkatëse. Edhe nëse vonesat sistematike mund të jenë më të justifikueshme se dobësitë individuale, duhet të vijë koha kur shkaqet sistematike nuk mund të konsiderohen më si shfajësuese. KEDNJ-ja nuk është një grup parimesh udhëzuese të imagjinuara ose shprehje e aspiratës së politikës shtetërore, synohet që shteti (ose autoriteti qeverisës) të marrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur shkeljen e KEDNJ-së. Në këto rrethana Z. Lajçi nuk mund të jetë përgjegjës për vonimin e hetimit.

E. Çfarë rrezikon z. Lajçi

²⁰ Shih citimin në poshtëshënimin 12 dhe ECtHR, *Ziacik v. Slovakia*, decision on the merits of 7 January 2003, paras. 44-45.

²¹ Shih p.sh., ECtHR, *Zimmerman & Steiner v. Switzerland*, judgment of 13 July 1983, Series A no. 66, paras. 27 to 32 and *Guincho v. Portugal*, judgment of 10 July 1984, Series A no. 81, paras. 40 to 41.

24. Dihet se, gjatë hetimit, z. Lajçi nuk është mbajtur në paraburgim dhe as nuk janë zbatuar masa kufizuese më të buta sesa paraburgimi. Gjithsesi, e njëjta gjendje ka vazhduar për më shumë se tri vjet dhe ka pasur ndikim të konsiderueshëm tek ai dhe te njerëzit e tij të afërm. Proceset penale duhet të përfundojnë. Gjithashtu, duhet të merret parasysh se periudha për më tepër se tre vjet është periudha para ngritjes së aktakuzës, dhe në qoftë se z. Lajçi do të akuzohej, kohëzgjatja e procedurave paraprake dhe e gjyqimit ka të ngjarë të jetë një periudhë po aq e gjatë, duke ndikuar në këtë mënyrë në ‘arsyeshmërinë’ e përgjithshme.
25. Së fundi, ndonëse është konstatuar se neni 159(1) i KPPK-së nuk zbatohet drejtpërdrejt në rregullën 47(1) të Rregullores, ose nuk është detyrues për Dhomat e Specializuara, është arritur në përfundimin se është *informativ* dhe rrjedhimisht, parashtrohet se, mund të përdoret si bazë ligjore për të argumentuar kriterin e “periudhës së arsyeshme”.

IV. PËRFUNDIM

26. Bazuar në sa më lart, Mbrojtja e Lajçit parashtroi dhe kohëzgjatja e hetimit, që tani i ka kaluar tre vjet dhe dy muaj, e ka tejkaluar “arsyeshmërinë” sipas kuptimit të rregullës 47(1) të Rregullores, duke marrë parasysh nenin 159(1) të KPPK-së dhe nenin 6(1) të KEDNJ-së.

27. Mbrojtja e Lajçit fton Gjykatësin e Vetëm të urdhërojë pushimin e hetimit në përputhje me rregullën 47(2) të Rregullores.

Numri i fjalëve (në origjinal): 3,079 fjalë

NDRYSHIM: Ky parashtrim është protokolluar si parashtrim i ndryshuar për shkak të mungesës së dy shtojcave konfidenciale të cilat i janë bashkëngjitur parashtrimit dhe ndryshimit të poshtëshënimit 9 që tani thotë Shtojca A konfidenciale dhe poshtëshënimit 10 që tani thotë Shtojca B konfidenciale.

/nënshkrimi/

Tobi Kadman

Mbrojtës i Specializuar i Driton Lajçit